Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr./Br. 63/17
Date/Datum 17.03.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit: **Ministria e Administratës Publike**	Kopje:	Paneli Shqyrtues - **OSHP Nr.63/17**
Nga:	Basri Fazliu - Ekspert shqyrtues i prokurimit		
Lënda:	Ekspertiza për lëndën **"Shërbime Inxhiniere profesionale për nevojat e MAP-it"**, me nr. prokurimi: **202/16/309/212**		
Përgjigjeje në ankesë:	**OE NTP "Proing & PMN & Ingeneering Group" Prishtinë**		
Datë	**17.03.2017**		

Bazuar në nenin 113.1 të LPP-së ju njoftojmë me ekspertizën e lëndës lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Shërbime Inxhiniere profesionale për nevojat e MAP-it"**, me nr. prokurimi: **202/16/309/212,** të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Administratës Publike** dhe me përgjigjeje ndaj ankesës së operatorit ekonomik: OE **"NTP "Proing & PMN & Ingeneering Group"**, me seli në – Prishtinë/Deçan, me nr.prot.63/17, i datës **03.03.2017**

Konform nenit 113.1, Pjesa IX e LPP-së, Eksperti Shqyrtues i pavarur, ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë, dhe ka konstatuar si më poshtë.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë, të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

1x1 Panelit Shqyrtues të OSHP-së.
1x1 Autoriteti Kontraktues.
1x1 Operatorit ekonomik ankues.

RAPORTI MBI EKSPERTIZËN E EKSPERTIT SHQYRTUES:

		10.03.2017		13.03.2017		17.03.2017
Nënshkrimi i ekspertit		Data e pranimit të autorizimit		data e fillimit të ekspertizës		data e dorëzimit të raportit të ekspertizës

N. 99, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit.

Me datë: 03.03.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka pranuar ankesën me numër të protokollit 63/17 e parashtruar nga operatori ekonomik NPN "Proing & PMN & Ingeneering Group"- lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Shërbime Inxhiniere Profesionale për nevoja të MAP-it", me nr. prokurimi: 202/16/309/212", të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Administratës Publike.
Konform nenit 113.1, Pjesa IX e LPP-së, eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë si më poshtë:

N. 111,-Operatori Ekonomik Ankues: NPN "Proing & PMN & ingeneering Group"- Prishtinë.

Neni 7 i LPP-së, Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi.

Neni 59 i LPP-së, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve.

Neni 72 i LPP-së, Dokumentacioni dhe informacioni shtesë.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Me datën 15.02.2017 nga Zyra e prokurimit pranë Ministrisë se Administratës Publike kemi pranuar Letër standarde për kandidadët e pa-kualifikuar ku thuhet:

Sipas MAP it ne nuk kemi ofruar dëshmi të mjaftueshme të qarkullimit finaciare për tri vitet e fundit (2013, 2014, 2015) sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktues. Po ashtu sipas MAP-it kemi ofruar ofruar ISO Certifikatën 9001-2008 me afat të skaduar.

Ne baze te ketij dokumeti shihet qarte se Zyra e Prokurimit se bashku me komisionin e vlerësimit gjatë vlerësimit te dokumetacionit te ofertes te dorëzuar nga ne si konzorcium nuk e kane respektuar Ligjin e Prokurimit Publik dhe legjislacionin sekondare pasi qe ne i kemi plotësuar te gjitha kërkesat e specifikuara ne njoftimin per kontrate dhe ne Dokumentin e Para kualifikimit, për te cilat kërkesa i kemi dorëzuara te gjitha dokumentet ashtu siç edhe është kërkuar.

Ju njoftojmë se ne njoftimin për kontrate dhe ne Dokumetin e Parakualifikimit është kërkuar tek Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale Kërkesa 4. Certifikata profesionale ISO 9001:2008

Dëshmia e kërkuar dokumentare: Evidenca 4: Certifikata profesionale ISO 9001:2008 (origjinal ose kopje e noterizuar)

Ju informojmë se sa i përket e kësaj kërkesë nuk qëndron arsya e cekur nga ana e juaj pasi qe kjo licence ka validitet deri me datë 09.10.2017 kjo munde te vertetohet ne licencen te cilën e gjeni ne dosjen e dorëzuara nga ana e jone ku specifikohet qarte se kjo licence është me afat 3 vjeçare nga data e regjistrimit.

Ndërsa sa i perkete kërkesës tek Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare

Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit (2013-2014-2015) ka qenë gjithsej jo më pak se 1,500,000.00 Euro.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Evidenca 1. Pasqyrat financiare të kompanisë, të shoqëruara me qarkullimi financiar nga banka për tri vitet e fundit (2013-2014-2015) apo deklaratat e tatimeve vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës apo kopjet e raporteve financiare të audituara e certifikuara nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur. Te plotësohet Aneksi 5

Ju informojme se ne kemi ofruar deshmi te mjaftueshme te qarkullimit financiar ashtu siq edhe eshte kerkuar nga ana e juaj. Ne ne dosjen tone kemi oftuar te detajuar qarkullimin bankar nga banka per tri vitet (2013, 2014 dhe 2015) po ashtu edhe dokumetin ku i specifikon per secilin vit qarkullimin dhe totali per periudhen 01.01.2013 deri me 31.12.2015 nga Raiffeisen

BANK. Njeherit ne e kemi plotesuar edhe aneksin 5 te Dokumetacionit te Parakualifikimit ashtu siq eshte keruar ku ne te tri keto dokumete shihet qarte se qarkullimi per periudhen e kerkuar kap shifren mbi 2 milion euro shume kjo e cila eshte mbi 600 mije euro me shume se sa kerkesa e specifikuar nga ana e Autoriteti Kontraktues. Andaj nga kjo shihet qarte se nuk qendron arsya se nuk kemi ofruar deshmi te mjaftueshme te qarkullimit financiar.

Andaj mendojme se gjate vlersimit te dokumetacionit per kete aktivitet te prokurimit Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar ligjin e prokurimit gjegjesisht

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi pasi qe nuk jemi trajtuar ne menyre te barabart me konkuretet tjerë. Po ashtu nuk eshte respektuar edhe nini 59 i LPP-se pasi qe nuk jane vlersuar drejte dokumetet te cilat ne i kemi dorezuar. Per qdo paqartesi qe mund te kete pasur gjate vleresimit te ketij aktiviteti Komisioni i vlersimit apo zyra e prokurimti pranë Ministrisë së Administratës Publike ka mundur qe ne baze te nenit 72 te kerkoj sqarime perkatese. Edhe pse mendojem se te gjitha dokuemtet e dorezuara jane ne perputhje me kerkesat e specifikuara ne Njoftimin per Kontrate dhe ne Dokumetitn e Parakualifikimit.

Prandaj, duke pasur parasysh këto fakte dhe dëshmi, duke dëshmuar me argumentet e mësipërme se ne si operatorë ekonomik pjesëmarrës i kemi përmbushur te gjitha kriteret e përcaktuara ne dosjen e tenderit, kërkojmë nga Ministria e Administratës Publike që lënda të kthehet në RIVLERËSIM.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit në KRPP-së për kontratë (N.35) :	29.12.2016
Lloji i procedurës së aplikuar (N.32-35):-	procedur e kufizuar
Lloji i kontratës së publikuar(N.16):	shërbime
Afati i fundit për pranim të tenderëve/Aplikacioneve.....	13.02.2017
Njoftimi për kandidat të pa-kualifikuar	14.02.2017
Kriter për dhënien e kontratës	Tenderi ekonomikisht ma i favorshem

Kriteret për kualifikim:

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:
Kërkesat :
a. Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-042, Neni 65.
b. Një dokument nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit para datës se publikimit të Njoftimit të Kontratës.
c. Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik I përmbush "Kërkesat e përshtatshmërisë"- të jetë i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit para datës se ublikimit të Njoftimit të Kontratës.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:
a. Një deklaratë e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar në dosjen e tenderit, Aneksi 2(Origjinal).
b. Vërtetimin nga Administrata Tatimore (kopje).
c. Vërtetimin nga Gjykata Themelore - Departamenti për Çështje Ekonomike (kërkohet origjinal ose i vërtetuar/noterizuar nga institucioni kompetent në vendin tuaj të themelimit). Dokumentet (nën b dhe c) duhet të dorëzohen vetëm ngatenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës. Në rast të shtimit në dorëzim të dokumenteve të tilla, tenderi i tyre do të refuzohet dhe AK do të vazhdojë me tenderuesin e listuar të radhës.

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:
Kërkesa 1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo Regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit;
Kërkesa 2. Regjistrimi i TVSH;
Kërkesa 3. Regjistrimi i Numrit Fiskal;
Kërkesa 4. Certifikata profesionale ISO 9001:2008
Kërkesa 5. Certifikata profesionale ISO 18001:2008

Dëshmia e kërkuar dokumentare:
Evidenca 1: Certifikata e regjistrimit te biznesit – kopje
Evidenca 2: Certifikata e TVSH – kopje
Evidenca 3: Certifikata e numrit fiskal – kopje
Evidenca 4: Certifikata profesionale ISO 9001:2008 (origjinal ose kopje e noterizuar)
Evidenca 5: Certifikata profesionale ISO 14001:2004 (origjinal ose kopje e noterizuar)

Nëse ne Certifikatën e Regjistrimit te biznesit është i shënuar edhe numri fiskal atëherë Certifikata e Regjistrimit te Biznesit shërben.
edhe si dëshmi e Certifikatës së numrit fiskal.

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:
Kërkesa 1.
Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit (2013-2014-2015) ka qenë gjithsej jo më pak se 1,500,000.00 Euro.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:
Evidenca 1. Pasqyrat financiare të kompanisë, të shoqëruara me qarkullimi financiar nga banka për tri vitet e fundit (2013-2014-2015) apo deklaratat e tatimeve vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës apo kopjet e raporteve financiare të audituara e certifikuara nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur.

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:
Kërkesa 1
Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka përfunduar min.5 kontrata të ngjashme per projektim dhe mbikqyrje gjatë 3 viteve të fundit(2013,2014,2015) në fushën e projektimit dhe mbikqyrjes . Vlera e kontratave duhet të jete minimum 1,000,000.00 Euro.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:
Dëshmia 1. Për cdo projekt, të bëhet përshkrimi me këto informata: titullin e kontratës, klientin, datën e fillimit të kontratës, datën e përfundimit të projektit, vlerën e projektit, përshkrimin e projektit dhe detyrave, dhe rolin e kompanisë ofertuese në zbatimin e kontratës (lider apo partner). Referenca kopje e notorizuar.

Komisioni vlerësimit pran AK-së:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues (N.80).

Armend RUGOVA: Kryesues DP,
Arta SHALA: Anëtar DSPIMNQ,
Mirvete GËRGURI; Anëtar DSPIMNQ,

Raporti i komisionit vlerësues:

Komisioni i vlerësimit pas kontrollit dhe verifikimit të ofertës konkurruese ka bërë kualifimin e ofertave si në vijim:
Infro Plus&Pro Ing - Prishtinë,
Intratec&Alfa-I – Prishtinë,
Alb Architect&North-Ëest – Prishtinë,

Përgjigjje në pretendimet ankimore nga Ekspertit shqyrtues: (N. 113.1), konform njoftimit të OSHP-së të datës 19.11.2014, nr.prot.848/14:

Në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të lëndës së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, bazuar në dokumentacionin që kanë pasur në dispozicion eksperti shqyrtues jep mendimin si në vijim:

Eksperti shqyrtues sqaron:
Autoriteti kontraktues gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedur të kufizuar, kriter për dhënie të kontratës ka qenë: "Tenderi ekonomikisht më i favorshem". I pakënaqur me njoftimin Letër standarde për kandidatët e pa-kualifikuar të datës 14.02.2017, për këtë aktivitet të prokurimit, operatoret ekonomik ankues, ka parashtruar kërkes për ri-shqyrtim të vendimin fillimisht në Autoritet kontraktues, pastaj duke parashtruar ankes edhe në OSHP, me datë 03.03.2017, me pretendimet ankimore se nuk janë respektuar neni:

Neni 7 i LPP-së, (Barazia në trajtim jo/diskriminimi),
Neni 59 i LPP-së, (Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve),
Neni 72 i LPP-së, (Dokumentacioni dhe informacioni shtesë).

Ne interpretim të asaj që u tha më lartë, po sqarojmë se i kemi shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndes, konkretisht ato që lidhen me zbatim të vendimit të lartë përmendur (pretendimeve ankimore) dhe atë si në vijim:

Sqarimi nr.1
Eksperti shqyrtues, njofton Panelin shqyrtues në lidhje me OE ankues në konzercium se i njëjti konzercium NUK ekziston dhe ankes në OSHP, është parashtruar njëanshem nga ana e OE në konzercium NPN Proing&PMN&Ingeneering Group", këtë e bazojmë në shkresën e dërguar nga ana e OE në korzercium ENGINEERING GROUP, të datës 22 Shkurt 2017, ku i njëjti OE njofton Autoritetin kontraktues se tërhiqet nga konzerciumi për këtë aktivitet të prokurimit duke deklaruar:

"Pro ling & PMN & Engineering Group" ne te cilen kemi marre pjese ne tenderin me emer: Sherbime Inxhinierike Profesionale per nevojat e MAP-it me nr. te prokurimit 202-16-120-212.

Arsyetim: Kompania Engineering Group ne CV e vete qe nga themelimi merret me ekzekutim te punimeve,duke e konsultuar ligjin se nese nje kompani mer pjese ne pergatitjen e projekteve dhe mbikqyrjeve nuk mund te shperblehet edhe me pune ndertimore dhe nese konzerciumi ne fjale do te jete

fitues i keti tenderi per projektim dhe mbikqyrje inxhinierike per nevojat e MAP-it, atehere kompania Engineering Group do ta humbe te drejten per te marre pjese ne tenderet per ndertim qe do te shpallen nga MAP-i mbrenda e tij, sepse eshte konflikt interesi, prandaj duke e pase parasysh qe kontrata per sherbime eshte e parapar per nje periudhe 3 vjeqare qe eshte nje periudhe e gjate kohore, ne me kete konkurim do ta humbnim te drejten e konkurimit per kete periudh qe do te investoj MAP-i.

Besojm se njoftimi i kompanise Engineering Group eshte i drejte dhe ne kohen e duhur, prandaj ne mbesim me shprese se do ta merrni parasysh".

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në këtë shkres të OE në konzercium *Engineering Group, ku i njëjti tërhiqet nga konzerciumi me arsyetimin e lartë cekur, vlerëson se ankesa e parashtruar nga ana e OE ankues në emër të konzerciumit është e njëanshme dhe NUK është parashtruar nga konzerciumi siç është përshktuar në ankes emri i konzerciumit, kjo dëshmon se të dhënat në ankes nuk janë të sakta, dhe e njëjta ankes NUK është në përputhje me nenin 111, paragrafi 1.5 lidhur me nenin 4 të LPP-së.* Eksperti shqyrtues, sqaron se tërheqja e anëtarit te konzorciumit e bënë të papërgjegjshëm këtë grup të operatorëve ekonomik, për faktin se ky konzorcium nuk i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit dhe deklaratat e parapara në nenin 71 të LPP-së.
Në lidhje me këtë çështje, eksperti shqyrtues, sqaron se KRRP, tek pyetjet e shpeshta, numër 17, e ka publikuar interpretimin për rastet kur tërhiqet anëtari i konzorciumit në të cilin thuhet se i tërë grupi duhet të refuzohet dhe tenderi i tyre të eliminohet nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit.

Eksperti shqyrtues, duke u bazuar edhe ne praktikat e mëhershme dhe interpretimet tjera te KRPP-se, për rastet e ngjashme është deklaruar se, bazuar në nenin 27 paragrafi 1 te Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, pika **c) ku thuhet se Anëtarët e grupit nënshkruajnë një deklaratë nga të gjithë për ta autorizuar partnerin udhëheqës të veprojë në emër të grupit**, nga kjo nënkuptohet se nëse ky konzorcium ushtron ndonjë ankesë ajo duhet të jetë e dorëzuar në emër të Konzorciumit dhe e nënshkruar nga partneri udhëheqës i autorizuar të veprojë në emër të grupit, e ne rastin konkret OE ankues "NPN Proing&PMN", nuk ka me autorizim nga anëtari tjetër i konzorciumit OE "Engineering Group".

Mendimi i Ekspertit Shqyrtues:

Eksperti shqyrtues duke u mbështetur në vlerësimet e lartë cekura, i rekomandon panelit shqyrtues që të HUDHET POSHTË si e PALEJUAR ankesën e OE e parashtruar në emër të konzerciumit "NPN Proing&PMN&Engineering Group", me seli në Prishtinë/Deçan, për këtë aktivitet të prokurimit: "Shërbime Inxhiniere profesionale për nevojat e MAP-it" me nr. prokurimi: 202/16/309/212", të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Administratës Publike.